

Analizë e pavarur ligjore mbi ndryshimet e Kodit Penal dhe rekomandime për lirinë e shprehjes

Kjo analizë e pavarur është përgatitur nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV).

- Analiza ligjore: Armando Bode, LLM
- Analiza e kontekstit mediatik dhe rishikimi: Dr. Blerjana Bino

Tiranë, shtator 2025

© SCiDEV 2025. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Ky dokument është hartuar në gjuhën shqipe dhe nuk ka kaluar proces redaktimi gjuhësor.

Hyrje

Më 25 korrik 2025, Ministria e Drejtësisë prezantoi [draftin e ri të Kodit Penal](#) dhe më 27 gusht 2025 ai u publikua në [Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike](#), duke nisur zyrtarisht procesin e konsultimit. Drafti përfaqëson një reformë madhore ligjore, me pasoja të drejtpërdrejta në funksionimin e shtetit të së drejtës, por njëkohësisht ka ngjallur shqetësime serioze për ndikimin e tij mbi lirinë e shprehjes, lirinë e medias dhe ushtrimin e rolit të rojtarëve publikë – gazetarë, aktivistë, mbrojtës të të drejtave të njeriut, organizata të shoqërisë civile dhe sinjalizues.

Ky raport ofron një analizë të pavarur dhe të argumentuar të neneve të draftit që mund të cenojnë lirinë e shprehjes dhe rolin e rojtarëve publikë, duke u fokusuar tek shpifja, fyerja, publikimi i akteve të hetimit, ndikimi në pavarësinë e gjyqësorit dhe kufizimet ndaj medias dhe lirisë së shprehjes në tërësi. Analiza mbështetet në raportet dhe analizat kërkimore të SCiDEV (si psh [Një Raport Hije për Lirinë e Medias 2024](#); [Raporti Vjetor për Gjurmimin e Progresit të Shqipërisë në Lirinë e Medias drejt Standardeve të BE-së](#)) dhe Rrjeti SafeJournalists (si psh [Raportet vjetore 2020-2025 Indikatorët e Lirisë së Medias dhe Sigurisë së Gazetarëve](#); [Raporti për Sigurinë e Gazetareve Gra 2024](#)), angazhimi i vazhdueshëm me komunitetin e gazetarëve dhe shoqërinë civile, standardet evropiane dhe ndërkombëtare, dokumentet e procesit të integritetit të Shqipërisë, si dhe [në advokimin e gjatë](#) të SCiDEV dhe partnerëve tanë të [Rrjetit të Gazetarëve të Sigurt](#) si dhe organizatave të tjera partnerë për liri të medias dhe të shprehjes.

Një nga problemet më të theksuara është mungesa e të dhënave të sakta dhe të disagreguara mbi procedimet penale për shpifje dhe fyerje. Sistemi statistikor gjyqësor nuk tregon nëse palët e përfshira janë gazetarë apo qytetarë, gjë që e bën të vështirë vlerësimin e plotë të ndikimit praktik. Prej vitesh, SCiDEV dhe [Rrjeti SafeJournalists](#) kanë advokuar për mbledhjen dhe publikimin e të dhënave të detajuara, duke theksuar rëndësinë e tyre për transparencë dhe politikëbërje të bazuar në prova. Megjithatë, evidencat ekzistuese janë shqetësuese: vetëm në vitin 2024, Gjykata e Tiranës regjistroi 77 çështje penale për shpifje dhe fyerje, por është e paqartë sa janë me palë gazetar. Gjykatat e Juridiksionit të Përgjithshëm në rrethe identifikuan 9 raste të qarta kundër gazetarëve – shumica të pushuara, një me gjobë dhe një ende në proces. Po 2024, Gjykata e Tiranës regjistroi 23 padi civile kundër gazetarëve dhe mediave për dëmshpërblime, përgënjeshtime ose heqje përmbytjesh.

Përmes [fokus-grupeve me gazetarë](#) dhe [tryezave të rrumbullakëta](#) që SCiDEV dhe Rrjeti SafeJournalists kanë zhvilluar në gjashtë vitet e fundit, ka dalë qartë se shpifja dhe fyerja të trajtuara si vepra penale janë ndër pengesat kryesore për gazetarinë investigative, sidomos kur preket korrupsioni madhor dhe abuzimi me pushtetin apo krimi i organizuar. Përballja me një proces penal sjell kosto të larta financiare, barrë emocionale dhe shpesh izolim, pasi redaksitë nuk ofrojnë mbështetje ligjore dhe solidariteti profesional mungon. Edhe kur proceset përfundojnë pa dënim, dëmi është i kryer: investigimet ndalen, vetëcensura shtohet dhe publiku humbet informacionin që i shërben interesit të tij.

Qasja e SCiDEV është e përcaktuar qartë: mbrojtja e gazetarisë në interes publik, integritetit të rojtarëve publikë dhe funksionit kritik të shoqërisë civile nuk mund të realizohet përmes sanksioneve penale. Këto role thelbësore për demokracinë dhe shtetin e së drejtës duhet të garantohen përmes mjeteve civile efektive, përfshirë përgënjeshttrimin, të drejtën e përgjigjes, dëmshpërblimet proporcionale dhe publikimin e vendimeve gjyqësore, të kombinuara me mekanizma të transparencës dhe vetërregullimit profesional si edhe masat kundër padive strategjike. SCiDEV nënvizon se kërkesa për dekriminalizimin e shpifjes dhe fyerjes nuk synon imunitet për gazetarët, por garantimin e lirisë së shprehjes si e drejtë themelore për të gjithë

shoqërinë. Gazetarët dhe rojtarët e tjerë publikë mbeten të përgjegjshëm përmes mjeteve civile, por nuk duhet të penalizohen penalisht për ushtrimin e një funksioni me interes publik.

Edhe pse dekriminalizimi i shpifjes dhe fyerjes nuk është një normë ndërkombëtare e detyrueshme, tendenca evropiane është qartësisht drejt dekriminalizimit ose moszbatimit të dispozitave penale për çështje të shprehjes. Atje ku këto dispozita vijnë në ekzistencë, ato kufizohen rreptësisht nga jurisprudenca e [Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut](#) dhe nga mekanizma të fuqishëm kontrolli institucional si për shëmbull gjyqësor i pavarur dhe vetërregullim profesional. Shqipëria nuk i zotëron ende këto garanci, çka e bën edhe më të domosdoshme shmangien e penalizimit potencial të fjalës së lirë përmes Kodit Penal dhe orientimin drejt mjeteve civile proporcionale dhe mekanizmave demokratikë të llogaridhënies.

Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është e konsoliduar në mbrojtjen e lirisë së shprehjes sikurse tregohet edhe në Udhëzuesi i Këshillit të Europës [“Kufizimi i përdorimit të ligjit penal për të kufizuar lirinë e shprehjes”](#). GjEDNJ ka përcaktuar se dënimet penale për shpifjen dhe fyerjen, sidomos dënimet me burgim, janë në parim joproporcionale dhe përbëjnë shkelje të nenit 10 të KEDNJ-së, përveç rasteve jashtëzakonisht të rënda si nxitja e dhunës apo e urrejtjes. Jurisprudenca thekson se edhe gjokat e rënda mund të krijojnë një efekt frikësues (“chilling effect”) mbi gazetarët, aktivistët, sinjalizuesit dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut, duke dekurajuar shprehjen e lirë dhe kritikën legjitime. Ngjashëm, Gjykata ka vlerësuar se edhe në rastet kur gjokat janë simbolike, por vijnë si rezultat i procedimeve penale, kanë një ndikim afatgjatë mbi të ardhmen e gazetarëve – pasi bëhet pjesë e rekordeve kriminale. Prandaj, trajtimi i këtyre rasteve, kërkon kriteret e shumta, ndër të tjera, dallimin e qartë ndërmjet deklaratave faktike dhe opinionit, duke theksuar se kritika politike dhe diskutimi mbi çështje me interes publik gëzojnë nivelin më të lartë të mbrojtjes. Në këtë kuadër, GjEDNJ ka vendosur që shtetet anëtare duhet të preferojnë mjete civile dhe masa proporcionale në mbrojtjen e reputacionit, duke shmangur penalizimin penal si mjet që cënon në vetvete lirinë e shprehjes dhe debatin demokratik.

Udhëzuesi i Këshillit të Europës [“Kufizimi i përdorimit të ligjit penal për të kufizuar lirinë e shprehjes”](#) thekson se ndëshkimet penale duhet të jenë mjeti i fundit dhe të përdoren vetëm për raste të rënda, si nxitja e dhunës ose gjuhë urrejtjeje, ndërsa shprehjet më pak të dëmshme nuk duhet të kriminalizohen. Ai vë në dukje rrezikun e përdorimit abuziv të ligjit penal për të heshtur gazetarët, aktivistët dhe zërat kritikë, gjë që dëmton pluralizmin dhe demokracinë. Edhe pse nuk është juridikisht detyrues, dokumenti ofron udhëzime autoritative të mbështetura në nenin 10 të [Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut](#), duke i kujtuar shteteve detyrimin për të mbrojtur lirinë e shprehjes dhe për të siguruar që çdo kufizim të jetë ligjor, i nevojshëm dhe proporcional.

Për më tepër, Shqipëria ka marrë angazhime të qarta në kuadër të procesit të integritetit evropian për respektimin e lirisë së shprehjes dhe sigurisë së gazetarëve. [Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës](#) (dhjetor 2023), [Agjenda Kombëtare e Reformave](#) në kuadër të Planit të Rritjes, si dhe [interim benchmarks](#) për grupkapitullin e parë (“[Fundamentals](#)”), parashikojnë në mënyrë eksplicite përafrimin e dispozitave civile dhe penale mbi shpifjen dhe fyerjen me standardet evropiane. Liria e shprehjes dhe siguria e gazetarëve janë të identifikuar jo vetëm si fusha kyçe për ecurinë e negociatave të anëtarësimit, por edhe si themel i proceseve demokratike në vend.

Gjithashtu, [rekomandimi](#) për dekriminalizimin e shpifjes dhe përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian dhe zbatimin e rekomandimit të Këshillit të Europës për Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike janë bërë të qarta edhe nga [Platforma e Dialogut të Hapur për Lirinë e Shprehjes](#), e ngritur me mbështetjen e Këshillit të Europës dhe Bashkimit Evropian dhe e

lehtësuar nga Departamenti i Gazetarisë i Universitetit të Tiranës, ka sjellë së bashku institucione publike (Ministrinë e Drejtësisë, Autoritetin e Mediave Audiovizive, Ministrin e Shtetit kundër Korrupsionit dhe Administratën Publike ndër të tjerë), organizatat mediatike dhe shoqatat e gazetarëve si edhe aktorë të tjerë të interesuar. Dokumentet shpjeguese dhe rekomandimet e zhvilluara nga Platforma e Strukturuar për Median janë vënë në dispozicion nga Këshilli i Europës nëpërmjet këtij [linku](#).

Ky raport ligjor është rezultat i ndjekjes së ngushtë të procesit nga SCiDEV, i [deklaratës së përbashkët me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë](#), si dhe i advokimit të vazhdueshëm për një reformë të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Ai është strukturuar në disa seksione që analizojnë nën për nen dispozitat problematike, duke i krahasuar me standardet ndërkombëtare dhe praktikrat evropiane, dhe mbyllet me një set rekomandimesh konkrete që do t'i dorëzohen Platformës së Konsultimit Publik për Kodin Penal, me qëllim përfundimtar për të kontribuar pozitivisht dhe nën frymën e bashkëpunimit, në procesin e hartimit dhe miratimit të një ligji me rëndësi madhore.

Analiza sipas neneve specifike që mund të cenojnë lirinë e shprehjes dhe veprimtarinë e profesionistëve të medias dhe rojëtarëve publik

Rregullimi aktual	Propozimi	Shënime	Vlerësimi
Neni 120 Shpifja¹	Neni 865 – Shpifja		
<i>Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë.</i> <i>Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.</i>	1. Përhapja e qëllimshme e deklaratave rreth një fakti specifik të rremë dhe ofendues, si dhe/apo çdo informacioni tjetër të rremë, që cenojnë nderin, vetëvlerësimin apo degradojnë reputacionin e personit apo institucionit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë deri në një milion e pesëqind mijë lekë dhe dënimin plotësues të përgënjeshtimit dhe faljen publike ndaj viktimës. 2. Nëse vepra penale është kryer nëpërmjet shtypit ose ndonjë mjeti tjetër komunikimi mediatik, elektronik, nëpërmjet rrjeteve sociale në internet, ose nëpërmjet një akti publik, dënimi shtohet deri në dyfishin e parashikuar në paragrafin e parë. 3. Nëse vepra penale i drejtohet një përfaqësuesi të një organi politik, administrativ ose gjyqësor, ose një anëtarit të tyre që funksionon në mënyrë kolegjiale, dënimet e parashikuara në paragrafin e parë apo të dytë shtohen deri me një të dytën.	- Ky nen zgjeron përkufizimin, duke shtuar se përbën shpifje nëse cenon “nderin, vetëvlerësimin apo degradojnë reputacionin e personit apo institucionit.” - Heq kërkesën “duke ditur që janë të rreme”, ndërkohë që Rekomandimi i KiE nr. 1814 (2007), ndër të tjera, parashikon edhe “mbrojtjen” në rastet kur deklaratat bëhen për interes publik, edhe nëse vërtetohet se nuk janë të sakta, nuk duhet të dënohen nëse provohet se ato u bënë pa dijeni dhe pa qëllimin për të shkaktuar dëme (ndryshe nga pika 7 e nenit të Fyerjes). - Shton dënimin plotësues të përgënjeshtimit dhe faljes publike ndaj viktimës, pavarësisht se është e paqartë përsëritja e këtij dënimi shtesë në pikën 6. - Shton konceptin e përjashtimit nga përgjegjësia penale nëse veprimet janë kryer në gjendje zemërimi. - Rishikon konceptin e veprës së kryer “botërisht”, duke specifikuar format e komunikimit (në pikën 2), por nuk është e qartë çfarë nënkupton me “akt	- Vlerësohet se ky nen nuk duhet miratuar. - Raportet e BE cilësojnë: EU Common Position (Fundamentals): “The EU underlines the importance for Albania to fully repeal criminal provisions on insult and defamation and align civil aspects of defamation with European standard”. EU Progress Report 2024: “In the coming year, Albania should in particular:[...] (ii) fully decriminalise defamation and align civil aspects of defamation with European standards, based on a structured and inclusive dialogue with media actors”. Rule of Law Report 2025: “Defamation remains a criminal offence, and the legal framework does not provide for safeguards regarding SLAPPs”. Nuk është në përputhje me: - Rekomandimin e KiE nr. 1814 (2007) “Towards decriminalisation of defamation”

¹ (Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001; ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012)

	4. <i>Cilido që ka kryer ndonjë prej veprimeve të parashikuara në këtë nen në gjendje zemërimi nuk ka përgjegjësi penale, nëse kjo gjendje dhe këto veprime janë kryer menjëherë si pasojë e një fakti të padrejtë të tjerëve ndaj tij.</i> 5. <i>Procedimi penal fillon me kërkesën e viktimës apo të përfaqësuesit të saj ligjor dhe çështja pushohet kur ajo heq dorë nga ankimi.</i> 6. <i>Kur vepra penale e shpifjes është kryer apo përhapur nga personi juridik i tij, gjykata vendos edhe detyrimin e publikimit të vendimit gjyqësor penal nëpërmjet medias apo në komunitet dhe, përgënjeshttrimin bashkë me faljen publike të tij.</i> 7. <i>Procedimi penal nuk e pengon viktimën t'i drejtohet edhe gjykatës civile.</i>	publik”, duke mos plotësuar kushtet për qartësinë e normës. - Rikthen mbrojtje të shtuar për funksionarët publikë, duke rritur penaltetin nëpërmjet pikës 3. Nuk është e qartë nevoja për rikthimin e këtij parashikimi, pasi në vitin 2012, nenet (neni 239 deri 241) të kësaj natyre u shfuqizuan, duke mos përmbushur parimin e proporcionalitetit, veçanërisht për sa kohë Kodi Civil ka parashikime që mbrojnë dinjitetin e individit. - Pavarësisht se nuk përmban dënim me burg (si forma më e rëndë e dënimit), dënimet penale, duke u bërë pjesë e rekordeve kriminale, kanë pasojë afatgjatë, stigmatizuese dhe dekurajuese, pasi çdo rekord kriminal mund të ndikojë mbi mënyrën e punës së profesionistëve të medias, veçanërisht gazetarëve, edhe në rastet kur gjobat janë simbolike. - Qoftë edhe kërcënimi i procedimit penal, mund të ndikojë negativisht në lirinë e shprehjes².	- Rezolutën e KiE nr. 1636 (2008) “Indicators for media in a democracy”³ - Praktikën e GjEDNj⁴ - Udhëzuesi i Këshillit të Europës “Kufizimi i përdorimit të ligjit penal për të kufizuar lirinë e shprehjes”
--	--	--	--

² Shih me tepër: [Limiting the Use of Criminal Law to Restrict Freedom of Expression a Guide to Council of Europe Standards](#)

³ Treguesi 8.2: Ligji nuk duhet të mbrojtë zyrtarët shtetërorë nga kritikën dhe ofendimet në një masë më të madhe se qytetarët e zakonshëm, si për shembull me dispozita që parashikojnë dënime penale më të rënda në të tilla raste. Gazetarët nuk duhet të dënohen me burg, dhe po ashtu organet e medias nuk duhet të mbyllën si pasojë e komenteve dhe opinionëve kritike.

⁴ Ndër të tjera: The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar, Animal Defenders International kundër Mbretërisë së Bashkuar, Medžlis Islamske Zajednice Brčko dhe të tjerë kundër Bosnjës dhe Hercegovinës [GC], Taner Kılıç kundër Turqisë, Magyar Helsinki Bizottság kundër Hungarisë [GC].

Neni 119 Fyerja ⁵	Neni 863 Fyerja		
Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë	1. Për qëllim të ligjit penal, përbën fyerje çdo veprim, fjalë ose shprehje që cenon dinjitetin e një personi tjetër, ose dëmton vetëvlerësimin e viktimës. Fyerje e rëndë do të vlerësohet të jetë veprimi, fjala apo shprehja që për shkak të natyrës, pasojave, rrethanave në të cilat është bërë apo zakoneve të mira që prek, përbëjnë shqetësim për opinionin publik. 2. Fyerja përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë. 3. Kur kundërvajtja penale është bërë në mënyrë publike, nëpërmjet çdo lloji mjeti të përhapjes së informacionit, dënimi shtohet me një të tretën e tij. 4. Procedimi penal fillon me kërkesë të viktimës dhe pushon kur ajo ose përfaqësuesi i saj ligjor, heq dorë nga kërkesa. 5. Fyerja e rëndë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy muaj. 6. Fyerja e rëndë, e kryer në mënyrë publike kur është përhapur me anë të shtypit, transmetimeve radiofonike ose me çdo mjet tjetër të ngjashëm, përbën kundërvajtje penale dhe e shton dënimin deri në një të tretën e tij. 7. Personi i akuzuar për fyerje përjashtohet nga përgjegjësia në rastin	- Ky nen zgjeron përkufizimin e fyerjes (<i>çdo veprim, fjalë ose shprehje që cenon dinjitetin e një personi tjetër, ose dëmton vetëvlerësimin e viktimës</i>). - Shton “fyerjen e rëndë” – kur përbën shqetësim për opinionin publik. - Nuk është e qartë çfarë nënkuptojnë shprehjet e mëposhtme: “dëmtimi i vetëvlerësimit të viktimës”; “zakonet e mira”; “shqetësim i opinionit publik”. - Pika 2 është e paplotë, nuk përcakton dënimin. Kjo nuk plotëson kushtet për qartësinë e normës. - Rishikon veprën e kryer botërisht. - Pika 5 përcakton burgim për fyerjen e rëndë, e cila nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit (veçanërisht pasi dënimi shtohet sipas pikës 6) dhe standardeve të referuara më sipër, në kuadër të jurisprudencës së GjEDNj, ku dënimi me burgim duhet të eliminohet plotësisht. - Pika 7 nuk është e qartë pasi ndërlidhet me zyrtarët publikë.	- Vlerësohet se ky nen nuk duhet miratuar. - Vlejnë referencat më sipër.

⁵ (Ndryshuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001; ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012)

	kur provon të vërtetën mbi veprimet ose shprehjet e drejtuara kundër zyrtarëve publikë për fakte që kanë të bëjnë me ushtrimin e detyrës ose kryerjen e kundërvajtjeve administrative.		
--	Neni 536 Ndikimi në pavarësinë e gjykatës		
--	Bërja apo publikimi i komenteve me anë të të cilave synohet haptazi të ushtrohet ndikim në aftësinë e gjykatës për të marrë vendimet, nëpërmjet krijimit të rrethanave shtypëse ndaj pavarësisë së saj, shtrembërimit të qëllimshëm të cilësisë së provave apo paraqitjes së tyre në kundërshtim me përmbajtjen e vërtetë, imponimit për të krijuar pabesueshmërinë në publik të aftësisë së gjykatës për të qenë e pavarur, të kryera për çdo interes apo përfitim, për të dëmtuar apo favorizuar persona të veçantë, e kryer përpara dhënies së një vendimi gjyqësor, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.	• Ky nen përbën një risi pozitive për të mbrojtur integritetin dhe pavarësinë e gjykatës. • Ka shprehje të paqarta si: “<i>Rrethana shtypëse</i>” apo “<i>Synohet haptazi</i>” – nuk është gjuhë standarde; mund të ishte lidhur me qëllimin. • Nuk ka mbrojtje për gazetarët – mund të keqpërdoret për të cenuar lirinë e shprehjes/opinionit ndaj proceseve gjyqësore me interes të lartë për publikun, të cilat cilësohen si kritike legjitime. • Praktika e vendeve të tjera kryesisht kufizohet me shpërndarjen e paligjshme të provave/aspekteve të hetimit (nene të tjera të Kodit Penal). • Masa me burgim mund të mos jetë proporcionale. • Në vende të tjera njihet si “<i>scandalizing the judiciary</i>”, me origjinë nga English Common Law. Në MB është shfuqizuar që nga viti 2013, për shkak të rrezikut që ngre ndaj lirisë së shprehjes.	- Vlerësohet se neni duhet rishikuar, edhe sipas Rec(2003)13 - Recommendation of the Committee of Ministers to member states on the provision of information through the media in relation to criminal proceedings (Adopted by the Committee of Ministers on 10 July 2003 at the 848th meeting of the Ministers' Deputies). - Sugjerim riformulimi: “<i>Publikimi i materialeve ose deklaratave faktike që, me qëllim ose me vetëdije për pasojat e tyre, krijojnë rrezik serioz dhe të menjëhershëm për drejtësinë e një çështjeje penale/gjyqësore në zhvillim, përbën kundërvajtje dhe dënohet me gjobë nga [...] deri në [...].</i> <i>Nuk përbëjnë vepër penale: (a) raportimi i drejtë e i saktë i procedimeve; (b) shprehjet e opinionit ose vlerësimit kritik; (c) publikimet e bëra në interes publik në mirëbesim; (d) komentet që nuk synojnë dhe nuk krijojnë rrezik serioz e të menjëhershëm.”</i>

			<i>Ky nen nuk pengon dhe nuk zëvendëson veprat penale të kërcënimit, korrupsionit, ndikimit të paligjshëm, zbulimit të të dhënave të hetimit apo pengimit të drejtësisë.”</i>
Neni 261 Pengimi në ushtrimin e të drejtës për t’u shprehur, grumbulluar apo manifestuar	Neni 852 Shkelje e lirisë së mendimit dhe shprehjes		
Kryerja e veprimeve për të penguar shtetasit për të ushtruar lirinë e shprehjes së mendimit, të grumbullimit apo manifestimit, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj. Kur veprimet shoqërohen me përdorimin e dhunës fizike, dënohen me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.	1.Mohimi ose kufizimi padrejtësisht i lirisë së fjalës dhe shprehjes në publik, lirisë së shtypit apo të komunikimit me mënyra të tjera, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit. 2. Dënimi shtohet deri në një të tretën e tij kur kundërvajtja penale sipas paragrafit të parë kryhet nga kushdo që urdhëron, detyron, kufizon apo padrejtësisht i mohon një gazetari të ushtrojë me vërtetësi vullnetin profesional të lirë për të regjistruar ose raportuar ngjarje e fakte reale, apo analiza dhe opinione të bazuara në to. 3. I njëjti dënim sipas paragrafit të dytë të këtij neni zbatohet edhe për këdo që në mënyrë të padrejtë pengon publikimin, shitjen apo shpërndarjen e librave, revistave, gazetave, apo çdo lloj shtypi tjetër, ose prodhimin, shpërndarjen e programeve radio dhe televizive, programeve të lajmeve të agjencive të shtypit, apo lëshimin e përmbajtjeve të tjera mediatike.	• Ky nen zgjeron mbrojtjen për lirinë e shprehjes, duke përfshirë në Kodin Penal edhe “lirinë e shtypit.” • Mund të rishikohet referenca vetëm në lirinë e “shtypit” për ta zgjeruar në lirinë e “medias,” për ndërlidhje me pikën 3 që përfshin edhe forma të tjera (programe radio dhe televizive). • Duhet ndërlidhur në mënyrë sistematike me masat Anti-SLAPP që do të ndërmerren eventualisht (jo në fushën e Kodit Penal). • Të vlerësohet mundësia që subjektet e cenuara sipas këtij neni të kërkojnë expedited review nëpërmjet masave të sigurimit.	- Vlerësohet se neni ka nevojë për përmirësime të mëtejshme. - Sugjerim “1.Mohimi ose kufizimi padrejtësisht i lirisë së fjalës, shprehjes në publik, lirisë së shtypit dhe medias, apo të komunikimit me mënyra të tjera, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit. 2. Dënimi shtohet deri në një të tretën e tij kur kundërvajtja penale sipas paragrafit të parë kryhet nga kushdo që urdhëron, detyron, kufizon apo padrejtësisht i mohon një gazetari [OSE profesionisti të medias] të ushtrojë me vërtetësi vullnetin profesional të lirë duke përfshirë mbledhjen e lajmit, regjistrimin, publikimin dhe shpërndarjen e ngjarjeve e fakte reale, apo analiza dhe opinione të bazuara në to. 3. I njëjti dënim sipas paragrafit të dytë të këtij neni zbatohet edhe për këdo që në mënyrë të padrejtë pengon publikimin, shitjen apo shpërndarjen e librave, revistave, gazetave, apo çdo lloj shtypi tjetër, ose prodhimin, shpërndarjen e programeve radio dhe televizive,

			<i>programeve të lajmeve të agjencive të shtypit, apo lëshimin e përmbajtjeve të tjera mediatike.</i> Me qëllim ofrimin e mbrojtjes të posaçme për gazetarët/profesionistët e medias, sugjerohen opsionet e mëposhtme: Opsioni 1: Në nenin 852, në vijim të propozimit më sipër, të shtohet pika 4: <i>4. Gazetarët/profesionistët e medias, në rast të kanosjes, goditjeve dhe vepra të tjera që i bëhen, me qëllim për ta penguar atë për të kryer detyrën apo shërbimin me interes publik sipas ligjit, kur cilësitë e tij janë të dukshme apo të njohura, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. OSE Gazetarët/profesionistët e medias, në rast të kanosjes, goditjeve dhe vepra të tjera, që i bëhen, me qëllim për ta penguar atë për të kryer detyrën apo shërbimin me interes publik sipas ligjit, kur cilësitë e tij janë të dukshme apo të njohura, gëzon të njëjtën mbrojtje sipas nenit 338 të këtij Kodi.</i> Opsioni 2: Neni 338 i draftit të Kodit Penal, të rishikohet duke përfshirë gazetarët/profesionistët e medias⁶:
--	--	--	--

⁶ Në shqyrtimin e këtij opsioni, të mbahet në vëmendje se KREU III, përfshin “VEPRAT PENALE KUNDËR VEPRIMTARISË SHTETËRORE TË KRYERA NGA SHTETASIT” dhe media nuk bën pjesë në këtë kategori, ndaj sugjerimi ynë është që të ndërlidhet me shërbimin me interes publik.

			Neni 338 Kanosja, kundërshtimi dhe goditja e punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim me interes publik 1. Kanosja, kundërshtimi me dhunë, goditjet dhe vepra të tjera, që i bëhet një punonjësi që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim me interes publik, me qëllim për ta penguar atë për të kryer detyrën apo shërbimin me interes publik sipas ligjit, kur cilësitë e tij janë të dukshme apo të njohura, dënohet me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. 2. Kur viktimë sipas paragrafit të parë të këtij neni janë profesionistët e arsimit, shëndetësisë ose medias (publike ose jo), dënimi me burgim shtohet deri në një të tretën e tij. 3. Në rast se kundërshtimi sipas paragrafit të parë apo të dytë të këtij neni bëhet në mjediset e punës, në mjedise publike, me sende të rrezikshme për jetën apo shëndetin, me sende të ndaluara për t'u mbajtur e përdorur në mjedise publike të caktuara për shkak të natyrës së veprimtarisë, apo kryhet nga një numër i madh personash, dënimi shtohet deri në një të dytën e tij.
--	--	--	---

	Neni 515 – Zbulimi i akteve ose i të dhënave sekrete të procedimit penal		
	1. Zbulimi i akteve sekrete ose i të dhënave, që përmbajnë aktet sekrete, nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, gjyqtari apo sekretari gjyqësor, avokati ose çdo subjekt që vjen në dijeni për to për shkak të detyrës gjyqësore, si dhe mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. 2. Zbulimi i akteve sekrete ose i të dhënave, që përmbajnë aktet sekrete, nga cilido, që është paralajmëruar nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore për moszbulimin e tyre, e shton dënimin e parashikuar në paragrafin e parë deri në një të tretën e tij. Nëse kjo vepër kryhet nga personat juridikë dënohet me gjobë ose me një nga dënimet e tjera parashikuar në nenin 123 të këtij Kodi. 3. Publikimi i akteve sipas paragrafit të parë të këtij neni, që sigurohen nga nëpunës apo burime zyrtare, që synojnë shfrytëzimin e tyre për interesa të çfarëdoshme të publikuesit duke u sjellë dëm interesave publike që lidhen me hetimin apo gjykimin e çështjeve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet. Nëse kjo vepër kryhet nga personat juridikë dënohet me gjobë ose me një nga dënimet sipas nenit 123 të këtij Kodi.	• Pika 2 nuk është e qartë nëse subjektet do të kufizohen vetëm në ato të listuara në pikën 1 – të cilat vihen në dijeni të akteve dhe të dhënave sekrete – për shkak të detyrës gjyqësore. • Referenca në pikën 2 bëhet te “cilido” dhe dënimi shtohet kur vepra kryhet nga personat juridikë, ndërkohë që asnjë nga subjektet e listuara në pikën 1 nuk është i tillë. • Kjo pikë, e lexuar së bashku me pikën 3, e cila lidhet me publikimin e akteve, mund të përbëjnë pengesë për profesionistët e medias, të cilët raportojnë për procese hetimore.	- Vlerësohet se ky nen ka nevojë të rishikohet për të ofruar qartësi mbi pikën 2, duke eliminuar mundësinë që ky nen të zbatohet ndaj profesionistëve të medias/rojtarëve publik.

Neni 268 - Poshtërimi i Republikës dhe i simboleve të saj ⁷	Neni 235 - Përdhosja e Republikës dhe simboleve të saj		
Dëmtimi i qëllimshëm i flamurit ose i stemës së Republikës, të ekspozuara në institucionet shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj. Poshtërimi botërisht i flamurit ose i himnit kombëtar, gjatë zhvillimit të një veprimtarie të organizuar nga autoritetet shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.	1. Përdhosja e Himnit Kombëtar, flamurit apo stemës së Republikës të ekspozuara në institucionet shtetërore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj ose, jo më pak se sa dy dënime plotësuese kur çmohet se arrihet qëllimi i dënimit penal nëpërmjet tyre. 2. Përdhosja e Republikës, Presidentit, Kuvendit, Këshillit të Ministrave, Gjykatës Kushtetuese ose sistemit gjyqësor, forcave të armatosura apo dëshmorëve të Atdheut, dënohet me burgim deri në tre vjet. 3. Përdhosja publikisht e Kombit Shqiptar, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet. 4. Nëse përdhosja sipas paragrafëve më sipër, kryhet gjatë një feste publike ose ceremonie zyrtare, dënohet me burgim deri në katër vjet. 5. Për qëllim të këtij ligji me përdhosje do të kuptohet dhunimi i diçkaje të shenjtë, vetive të larta morale apo vlerave të nderuara botërisht, poshtërimi, bërja e padobishme, përçmimi, tallja, përlyerja, apo përbuzja	• Pika 2 e këtij neni zgjeron zbatimin e veprës penale të përdhosjes (duke zëvendësuar poshtërimin) te Republika, Presidenti, Kuvendi, Këshilli i Ministrave, Gjykata Kushtetuese, sistemi gjyqësor, forcat e armatosura apo dëshmorët e Atdheut, duke parashikuar edhe dënime më të rënda me burgim, të cilat rriten për veprime që kryhen gjatë festave publike ose ceremonive zyrtare. • Përfshirja e figurave të mësipërme mund të cenojë lirinë e shprehjes në kuadër të diskursit publik/politik, humorit/satires dhe kritikës. • Origjina e këtyre veprave penale është nga ligjet <i>lèse-majesté</i> (injured majesty). • Specifikisht për figurat e mësipërme, trendi në Europë është drejt shfuqizimit të parashikimeve të kësaj natyre, pasi cenojnë lirinë e shprehjes. P.sh., Franca shfuqizoi parashikimet për “fyerjen e Presidentit” pas vendimit të GjEDNj <i>Eon v. France</i>. Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese e Belgjikës ndërmori një reformë të ngjashme në vitin 2021.	• Vlerësohet se ky nen duhet rishikuar, duke hequr pikën 2.

⁷ (Ndryshuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012)

	e institucioneve të përmendura në këtë dispozitë.		
--	---	--	--

Rekomandime të përgjithshme

1. Dekriminalizimi i shpifjes dhe fyerjes

- Shfuqizimi i dispozitave penale për shpifjen dhe fyerjen, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, Këshillit të Europës dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- Trajtimi i çështjeve të cilat synojnë mbrojtjen e reputacionit dhe dinjitetit përmes mjeteve civile proporcionale, si përgënjeshtrimi, e drejta e përgjigjes, kompensimet civile dhe publikimi i vendimeve gjyqësore.

2. Forcimi i mbrojtjes së gazetarëve dhe rojtarëve publikë

- Njohja e gazetarëve dhe profesionistëve të medias si kategori e mbrojtur gjatë ushtrimit të detyrës, përmes përfshirjes së tyre në dispozitat që parashikojnë mbrojtje ndaj kërcënimeve, dhunës dhe pengesave në punë.
- Përafrimi i legjislacionit me masat anti-SLAPP, duke parandaluar përdorimin e padive strategjike për të heshtur kritikën dhe debatin publik.

3. Rishikimi i dispozitave që potencialisht kufizojnë shprehjen

- Rishikimi i neneve që parashikojnë dënime penale për përdhosjen e figurave shtetërore, pasi cenojnë diskursin politik, satirën dhe kritikën legjitime.
- Qartësimi i neneve mbi ndikimin në gjykata dhe publikimin e akteve të hetimit, për të shmangur interpretimin arbitrar dhe cenimin e raportimit me interes publik.

4. Harmonizimi me angazhimet evropiane dhe ndërkombëtare

- Përafrimi i plotë i dispozitave të Kodit Penal me angazhimet e *Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës* (dhjetor 2023), *Agjendës Kombëtare të Reformave* dhe *interim benchmarks* për kapitullin “Fundamentals”.
- Zbatimi i rekomandimeve të Platformës së Dialogut të Strukturuar për Lirinë e Shprehjes dhe Sigurinë e Gazetarëve, e mbështetur nga BE dhe Këshilli i Europës, sidomos për dekriminalizimin e shpifjes dhe përafrimin me masat anti-SLAPP ([Direktiva e BE](#), [Rekomandimi Këshillit të Europës](#)).

5. Sigurimi i proporcionalitetit dhe qartësisë ligjore

- Eliminimi i gjuhës së paqartë dhe subjektive në dispozitat ligjore (p.sh. “zakonet e mira”, “shqetësim i opinionit publik”, “akte publike”), në përputhje me parimin e cilësisë së ligjit dhe qartësisë së normës, me qëllim garantimin e sigurisë juridike.
- Vendosja e mekanizmave të qartë dhe proceduriale për të mbrojtur gazetarët dhe aktorët e shoqërisë civile nga pengesat në ushtrimin e funksioneve të tyre.